

VENDIM
Nr. 99, datë 4.7.2017

**MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN E SHËRBIMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET OST SHA DHE
FURNIZUESIT MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 23, DATË
15.2.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, pika 4 e VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.7.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi propozimin e shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017,

konstatoi se:

- Me vendimin me nr. 23, datë 15.2.2017, bordi i ERE-s ka miratuar “Marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit”.

- Me hyrjen në fuqi të marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, u paraqit në ERE me shkresën nr. 2933 Prot, datë 7.4.2017, propozimi i shoqërisë OST sh.a. për disa ndryshime në këtë marrëveshje.

- ERE, me vendimin nr. 64, datë 11.5.2017, miratoi fillimin e procedurës “Për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017”.

- Me shkresën me nr. 100/24 Prot., datë 17.5.2017, publikoi për 3 ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për vendimmarrjen e sipërcituar të bordit. Me anë të këtij njoftimi u ftuan të gjithë palët e interesuara për të shprehur opinionet dhe komentet e tyre brenda 15 ditëve pune.

- Me shkresën nr. 402 Prot., datë 22.5.2017 dhe 421 Prot., datë 30.5.2017, ERE përcolli vendimin me nr. 64, datë 11.5.2017, “Për fillimin e procedurës mbi disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017”, si dhe ndryshimet e kërkuara nga shoqëria OST sha, për marrje mendimi, pranë subjekteve: MEI, Autoriteti i Konkurrencës, OSHEE, KESH, shoqatave AAES, FIAA dhe AREA.

- Shoqata AAES, me shkresën e saj nr. 16/1 Prot., datë 26.5.2017, ka përcjellë në ERE dakortësinë e saj në lidhje me ndryshimet e propozuara nga shoqëria OST sh.a. “Për disa ndryshime në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017”.

- Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 204/2, datë 22.6.2017, u shpreh se nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në marrëveshjen e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 23, datë 15.2.2017, si më poshtë:

- Në nenin 1, pika “Përfaqësues i autorizuar”, bëhet: “Përfaqësues i autorizuar është personi i ngarkuar zyrtarisht nga titullari i kompanisë për ndjekjen e kësaj kontrate”.

- Në nenin 4, pika 4.1 bëhet: “_____ (F) do të informojë OST për sasinë e energjisë elektrike, nominimin me bazë orare, me numra me presje dhjetore deri në tri shifra pas presjes, të energjisë që do të transmetohet për llogari të _____ (F) nga pikat e marrjes në pikat e dhënies, për ditën në avancë, jo më vonë se ora 14.00 të çdo dite (në ditën D, për ditën D+1). Për ditët e fundjavës ose të festave, programi do të jepet në avancë, në ditën e fundit të punës dhe do të përfshijë ditët e pushimit dhe ditën e parë të punës pas pushimit. Programi (nominimi) i deklaruar nga _____ (F) paraqet një tabelë sipas aneksit 2, ku për çdo orë të ditës në avancë, jepet energjia (fuqia, kapaciteti në MW) që parashikohet të furnizohet dhe tërhiqet (konsumohet) në të gjitha pikat e matjes sipas aneksit 5. _____ (F) ka të drejtë të bëjë ndryshimin e skedulimit ditor, në çdo kohë, me kushtin që versioni i ri i skedulimit (nominimit) të jetë harmonizuar më parë me kaunterpartin përkatës (në anën tjetër të kufirit në rastin e importit, ose me centralin furnizues përkatës brenda vendit) dhe të deklarohet në OST, jo më vonë se 90 minuta para bërjes efektive të ndryshimit në rastin e transaksionit ndërkufitar dhe jo më vonë se 60 minuta para bërjes efektive të ndryshimit për transaksionin e brendshëm, në mënyrë të tillë që nominimi të jetë sa më afër kohës reale të transaksionit”.

- Neni 15, pika 15.1 bëhet: “Menjëherë pas firmosjes së kësaj kontrate, çdo palë do të përcaktojë me shkrim një përfaqësues të autorizuar (përfaqësuesi i autorizuar)”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti